



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Eventi Sportiv të organizuar nga "Ekipet Sportive në Shkollë"

"Procedurë prokurimi për shërbim design, editim, faqosje dhe përgatitje për shtyp e librit "Team Albania Edicioni 3".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH
2. Rreth shërbimit të kërkuar.....
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.....
4. Metodologjia dhe plani i punës
5. Kualifikimet e nevojshme
6. Procesi i aplikimit.....
7. Dorëzimi i ofertave
8. Afati i Aplikimit.....
9. Procesi i Vlerësimit.....
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Shërbime organizimi të ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të dokumentuar e promovuar aktivitetet sportive, parashikohet realizimi i një botimi përmbledhës në funksion të pasqyrimit të veprimtarisë vjetore në kuadër të projektit “Ekipet Sportive në Shkollë”.

Në këtë kuadër, parashikohet përgatitja, editimi, shërbimi design, faqosja dhe përgatitja për shtyp e librit “Team Albania Edicioni 3”, i cili do të përmbledhë në mënyrë të strukturuar aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit, përfshirë eventet sportive, ndeshjet, trajnimet, kampionatet dhe arritjet kryesore, si medaljet dhe rezultatet e sportistëve. Ky botim do të shërbejë si një material zyrtar informues dhe promovues i veprimtarisë së organizatës.

Ftojmë individët/kompanitë që ushtrojnë aktivitet në fushën e botimeve, shtypshkronjës dhe përgatitjes së materialeve didaktike, dhe që janë të interesuar për bashkëpunim, të angazhohen në realizimin e këtij shërbimi në kuadër të aktiviteteve të KOKSH.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me specifikimet e kërkuara.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmimi pa Tvsh	Vlera	Burimi i Financimit	Kohëzgjatja/ Periudha e përmbajtjes
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>l</i>	<i>2</i>	<i>3=lx2</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
1	Shërbim për design grafik, editim, faqosje dhe përgatitje për shtyp e librit “Team Albania Edicioni 3”	Përgatitje për design grafik, editim, faqosje dhe përgatitje për shtyp e librit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor	Nr	1	lekë		Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	Sipas afateve të edicionit të 3 të projektit (2024–2025)

4. Metodologjia dhe plani i punës

Për realizimin me cilësi të këtij shërbimi, do të përzgjidhet operatori ekonomik që paraqet ofertën më të favorshme ekonomikisht, në përputhje me kërkesat teknike dhe financiare të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Metodologjia e ndjekur do të përfshijë:

- Identifikimin dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik përmes një procesi transparent dhe konkurrues;
- Hartimin e një plani të detajuar pune për përgatitjen e librit, në përputhje me kërkesat e projektit “Ekipet Sportive në Shkolla”;
- Mbledhjen, strukturimin dhe editimin e materialeve (tekste, foto, të dhëna) që pasqyrojnë aktivitetet vjetore, në gjuhën shqipe dhe angleze;
- Realizimin e dizajnit grafik dhe faqosjes profesionale të librit, në përputhje me standardet e publikimeve institucionale;
- Përgatitjen e materialeve për shtyp, sipas specifikimeve teknike të miratuara;
- Koordinimin e vazhdueshëm me autoritetin kontraktor për shqyrtimin dhe miratimin e drafteve në çdo fazë të procesit;



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

- Dorëzimin e materialeve finale të gatshme për botim brenda afateve të përcaktuara;
- Monitorimin e cilësisë së shërbimit gjatë gjithë procesit, përmes verifikimeve dhe komunikimit të vazhdueshëm me palët e përfshira.

Kohëzgjatja e këtij shërbimi do të jetë në përputhje me afatet e zbatimit të projektit “Ekipet Sportive ne Shkolla”, duke synuar përfundimin e përgatitjes dhe botimit të librit brenda periudhës 6 mujore.

5. Kualifikimet e nevojshme

- Regjistrimi ligjor: Subjekti duhet të jetë i regjistruar në QKB dhe të ketë në objekt të veprimtarisë shërbime në fushën e botimeve, shtypshkronjës, dizajnit grafik ose të ngjashme;
- Të paraqesë ofertën në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor;
- Aftësi për realizimin e përgatitjes redaksionale, design grafik dhe faqosjes së materialeve;
- Kapacitet për printimin dhe botimin e librit sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Për të qenë i përshtatshëm për këtë prokurim, ofertuesi duhet të plotësojë këto kriteret kualifikuese:

- Eksperiencë e mëparshme në përgatitjen ose botimin e librave apo materialeve;
- Aftësi për të ofruar shërbimin sipas kërkesave, duke garantuar cilësinë e përmbytjes, printimit dhe afatet kohore të dorëzimit;
- Përgatitja e një oferte të detajuar, që pasqyron qartë procesin e punës (redaktim, design, printim), çmimin dhe afatet e realizimit;
- Kapacitet teknik dhe profesional për realizimin e shërbimit design, faqosjes dhe përgatitjes për shtyp të librit;
- Aftësi për bashkëpunim dhe koordinim me autoritetin kontraktor gjatë gjithë fazave të procesit (draft, miratim).

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte dhe person kontakti.

6. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

7. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 17.12.2025 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhen Shqipe.

8. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Çmimi - Vlerësohet oferta më e favorshme ekonomike, bazuar në çmim	70%
Cilësia dhe kapaciteti – Vlerësohen cilësia e ofertës teknike (përgatitja redaksionale, shërbimi design grafik, faqesja, cilësia e printimit), si dhe aftësia e operatorit për realizimin dhe dorëzimin e librit brenda afateve	30%

9. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.